




REPUBLICA E KOSOVES		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	D2K	Bi Prot.	02-01/4191/17
Dep.		Prot. No.	
Nr. Titull		Data	
Pro. Strategjia	02	Datum	20.12.2017
Nr. pages		Day	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.12.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3746/17, për znj. Ardita Rizvanolli, Kryesuese e Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave Çabrati - Gjakovë, për shkak se zyrtarja e lartë publike e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Ardita Rizvanolli, Kryesuese e Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave Çabrati - Gjakovë dhe njëkohësisht "person i autorizuar" në biznesin privat N.T.Sh "Atele Ardita Fashion", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtarja e lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimi të kësaj shkrese zyrtarja e lartë është njoftuar me fakte se ushtrimi i funksionit menaxhues në biznes privat është i ndaluar neni (15 paragrafi 1) të Ligjit nr.04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Zyrtarja e lartë, është deklaruar se brenda afatit ligjor do të ndërmerr veprimet e nevojshme me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë zyrtare të lëshuara nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/4100/17) me të cilën dëshmohet se zyrtarja e lartë është larguar nga funksioni “person i autorizuar” në biznesin privat të cekur më lartë. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

